



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:196675

Datë: 28.10.2022

Numri i dokumentit: 03582905

PKR.nr. 187/22

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Krimeve të Rënda**, me kryetarin e trupit gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të akuzuarit H. Z. nga fsh. S. i E., K. Deçanit, i akuzuar për shkak të veprës penale, **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par.1, të KPRK-së, si dhe për shkak të veprës penale, **“Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm”**, nga neni 367 par.1, të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për krime të rënda, PP/I. Nr.225/2022, të datës 23.09.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 21.10.2022, në prezencë të Prokurores së shtetit Sahide Gashi, të akuzuarit H. Z., si dhe mbrojtësi i tij, av. Flamur Bllacaku sipas autorizimit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli me datën **21.10.2022**, ndërsa me dt.28.10.2022, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari,**

**H. Z.**, i biri i B. dhe nënës Gj. e vajzërisë G., i lindur me dt. e lindjes në fsh. S. i E., K. D., ku edhe banon, i martuar, babi i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit numër personal, posedon numër te telefonit. (numër gjerman) dhe .../...-..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, **tani gjendet në liri.**

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

I. Më dt. 24.06.202, në fshatin N., K Pejë, në orët e paradites ka mbajtur në kontroll armë e municion në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë, konkretisht nenin 17, par.1, nënpar.1.4, si dhe nenin 22 e 38, par.1, e par.1.3 të Ligjit për Armë Nr. 05/L -022 dhe atë pistoletën e tipit S. S, modeli P. mm, me nr. Serik ..., në atë mënyrë që edhe pse ka poseduar Lejen për armën në fjalë Nr.DC.... vetëm për Shenjëtari, i njëjti me rastin e një gazmendi familjar shtien me armën në fjalë e pasi policia vije në dijeni, të njëjti i sekuestrohet arma dhe municioni në fjalë.

- Me çka ka kryer veprën penale, “**Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve**”, nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

--

II. Me datë 24.06.2022 në fshatin N. K Pejë, në orët e paradites ka përdorë armë apo materie plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, nenin 17, par.1, nënpar.1.4, si dhe nenin 22 e 38, par.1, e par.1.3 të Ligjit për Armë Nr. 05/L - 022 dhe atë pistoletën e tipit S. S, modeli P...mm, me nr. Serik ....., në atë mënyrë që edhe pse ka poseduar Lejen për armën në fjalë Nr.DC.... vetëm për Shenjëtari, i njëjti me rastin e një gazmendi familjar incizohet me telefon celular tek shtien me armën në fjalë dhe këtë video xhirim e poston në faqen sociale “F.”, e pasi policia vije në dijeni, të njëjtit i sekuestrohet arma dhe municioni në fjalë.

- Me çka ka kryer vepër penale, “Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm”, nga neni 367 par.1, të KPRK.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 8, 9, 10 par.1, 17 par.1, 21,38, 39 par.1, 40 par.1 pika 1.2 dhe 1.3, 42, par.1 nën par. 1.1 dhe 1.2, 43 par.1 nën par. 1.3, 44, 69, 71, 72 par.1 pika 1.5, nenin 366 par.1 dhe neni 367 par.1, të KPRK-së, dhe nenit 245, 246, 359, 360, 361, 362, 365, 366 dhe 450 të KPPRK-se, të pandehurin H. Z. e:

### P ë r c a k t o n

Për veprën penale nga dispozitivi I, të këtij aktgjykimi, dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro.

Për veprën penale nga dispozitivi II të këtij aktgjykimi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muaj, e i cili dënim me pëlqimin e tij i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro.

Ne kuptim të nenit 76 par.1 dhe par.2 nën par 2.4 të KPRK-së, gjykata të pandehurin H.Z. e:

### G J Y K O N

- Me dënim unik me gjobë në shumë prej 900 (nëntëqind) euro, e të cilin dënimi i njëjti ka për tu pagabuar në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- Me pëlqimin e të pandehurit e në përputhje me nenin 44 par.1.2, të KPPK-ës, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj nga pika II, i është zëvendësuar me dënim me gjobe në shumë prej 300 (treqind) euro, ashtu që shuma e përgjithshme e dënimit është 900 (nëntëqind) euro.
- Dënimin me gjobë nga në shumë të përgjithshëm prej 900 (nëntëqind) euro, i pandehuri, duhet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Nëse i pandehuri nuk e ekzekuton dënimin me gjobë në shumën e përgjithshme prej 900 euro, dështon apo refuzon ta paguaj dënimin me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim duke i llogaritur për një ditë burgimi vlerën nga 20 euro.
- Obligohet i pandehuri në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale në shumë prej 30€ (tridhjetë) euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, shumën prej 50 (tridhjetë) €.
- **KONFISKOHET** një pistoletën e tipit SIG ., modeli P...mm, me nr. Serik ..., një karikator të njëjtës armë si dhe leja për armë me nr. DC...dhe të njëjtat kanë për tu **SHKATËRRUAR** pasi që aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjën PP/I. Nr.225/2022 të datës 23.09.2022, kundër të akuzuarit H. Z. nga fsh. S. i E., K. Deçani për shkak të veprës penale, “Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par.1, të KPRK-së, si dhe për shkak të veprës penale “Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm”, nga neni 367 par.1, të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 21.10.2022, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Shtetit Sahide Gashi, i pandehuri H. Z. si dhe mbrojtësi i tij, av. Flamur Bllacak sipas autorizimit që gjendet në shkresat e lëndës.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores së shtetit nën shenjën PP/I. Nr.225/2022, të datës 23.09.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurores së Shtetit, të pandehurit H. Z. dhe mbrojtësi i tij, av. Flamur Bllacaku, gjykata është bindur se, i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit ju ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë duke e udhëzuar të njëjtin me kushtet privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 248 par. 1 e gjerë në piken 1.4, të KPPK-ës.

Në këtë rast gjykata pas udhëzimit për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i akuzuari ka deklaruar se, i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e **pranon fajësinë**, për veprës penale, “Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par.1, të KPRK-së, si dhe për shkak të veprës penale, **Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1, të KPRK-së**, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim, i vjen keq për veprimet e bërë.

Prokurorja e shtetit, në lidhje me pranimin e fajësisë, nga ana e të pandehurit, H. Z., ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë, meqenëse ka mbështetjen në shkresat e lëndës dhe i propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta APROVON.*

Mbrojtësi i të pandehurit H.Z, av. Flamur Bllacaku, në lidhje me pranimin e fajësisë ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë meqenëse ky pranim i fajësisë është bërë pas konsultimeve me mua dhe të njëjtin pranim e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, dhe i propozoi gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovon.*

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, konsultimet e mjaftueshme me mbrojtësin e tij.

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, siç janë: *Raporti fillestar të incidentit i datës 18.07.2022; Raporti i policit hetues R. P. i datës 18.07.2022, Deklarata e të dyshuarit H. Z. e dhënë në polici me datën 18.07.2022; Lista e dëshmimeve më nr. 2022-/-1227 i datës 18.07.2022; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 18.07.2022; Foto albumi i rastit më nr. të rastit 2022-/-1227, si dhe shkresa tjera të lëndës, po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit rrjedh se në veprimet e të pandehurit H. Z., qëndrojnë të gjitha elementet e veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1, të KPRK-së si dhe për shkak të veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1, të KPRK-së.*

Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe duke u ndërlidhur me atë se, ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 248 par 1, të KPPRK-së, atëherë, ne këtë çështje penale, nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë, mendimit të prokurorit të shtetit ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Prokurorja shtetit lidhur me rrethanat lehtësuese dhe renduese ka deklaruar se: *si rrethane renduese i propozoj gjykatës të vlerësoi rrezikshmërinë që paraqesin këto vepra penale, gjersa si rrethane lehtësuese të merr parasysh se i njëjti ka pranuar veprat në çdo fazë të procedurës, faktin që nuk ka ra ndesh me ligjin me herët si dhe pranimi i fajësisë edhe në këtë shqyrtim.*

Mbrojtësi i të pandehurit lidhur me rrethanat lehtësuese dhe renduese ka deklaruar: *pranimi i fajësisë është si rrjedhojë e përgjegjësisë morale e te pandehurit qysh në fazën e parë të procedurës ka pranuar fajësinë dhe është mbështetur në të gjitha provat. Rasti ka ndodhur në një gjendje kur ai ka qene i emocionuar dhe në momentin kur është paraqitur në polici ka shpreh keqardhje dhe e ka ndier veten të përgjegjshëm për këto vepra penale. H. Z. është në pension i cili ka ndihmuar atë familje dhe kjo ka qene arsyeja pse ka qene i emocionuar. I njëjti nuk është recidivist i kësaj vepre penale ose të ndonjë vepre tjetër penale dhe nuk është dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prere. Është qytetar i ndershëm i Republikës së Kosovës dhe në vazhdimësi mundohet që të kontribuon për të mirën e përgjithshme. Nuk ka asnjë rrethane renduese, andaj propozoi gjykatës që nga pranimi i fajësisë të shqiptoi dënim me gjobë në raport me gjendjen ekonomike e në rast që të njëjtit ti shqiptohet dënim me burgim, ti mundësohet zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë dhe i propozoi gjykatës që të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese.*

I pandehuri lidhur me rrethanat lehtësuese dhe renduese ka deklaruar se: *e mbështes deklarimin e mbrojtësit tim, me vjen keq që ka ndodhur, nuk kam çka të shtoi më shumë.*

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprat penale ti kryej në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale, nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Kryetari i trupit gjykues në aplikim të neneve 69 dhe nenit 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara e të përmendura nga ana e Prokurorit të Shtetit gjatë seancës të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri në të gjitha fazat si dhe në shqyrtimin fillestar ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetshme, po ashtu pendimin e tij për veprën e kryer, sjelljen e tij korrekte gjatë shqyrtimit, moshën e tij të pleqërisë, mosdenueshmerine e tij të mëparshme, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe peshën e veprës penale.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit për veprën penale, “Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm”, nga neni 367 par. 1, të KPRK-së, e për të cilën ka qenë i akuzuar i pandehuri, ka aplikuar dispozitat të cilat kanë të bëjnë me zbutjen e dënimit, e krejt kjo duke pasur parasysh rrethanat veçanërisht lehtësuese të cekura si më larte, ashtu që duke vepruar konform dispozitave ligjore të nenit 71 dhe 72 par. 1 nën par. 1.5, të KPRK-së, e ku përcaktohet se “nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim”, ashtu që gjykata të njëjtit i ka shqiptuar dënimin me burgim ndër minimumit të parapare ligjor në aplikim të këtyre dispozitave dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me gjobë për veprën penale “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1, të KPRK-së, u morr konform nenit 43 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me burgim për veprën penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1, të KPRK-së, u morr konform nenit 42, të KPRK-së.

Gjykata konform dispozitës ligjore të nenit 44 par. 1, dhe 2, të KPRK-së, i ka dhënë mundësinë që dënimi me burgim sipas pikës II të aktgjykimit, ti zëvendësohet me dënim me gjobë në shume prej 300 (treqind) euro, ashtu që i njëjti pas shpalljes së aktgjykimit burimor ka dhënë një pëlqim të tillë, te njëjtën ditë duke parashtruar Kërkesë, e cila është pranuar me dt. 21.10.2022, me vulë te gjykatës.

Pas dhënies së pëlqimit nga ana e të pandehurit për zëvendësimin e dënimit të shqiptuar me burgim në dënim me gjobë, gjykata konform nenit 76 par. 2 nën par. 2.4 të KPRK-së i shqiptoi dënim unik me gjobe si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi për zëvendësimin eventual e dënimit të shqiptuar me gjobë me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon apo refuzon ta paguan dënimin me gjobë u morr konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit plotësuese - konfiskimin e armës dhe shkatërrimin e saj, u morr konform nenit 366 par. 3, të KPRK-së.

Vendimi për paguarjen e shpenzimeve procedurale, u morr konform nenit 450 par. 1, par.2 nën pika 2.6, të KPPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u morr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit NR.05/L-36.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
PKR.nr.187/22 e dt.28.10.2022**

**Bashkëpunëtorja profesionale,  
Teuta Spahija**

**Kryetari i Trupit Gjykes,  
Dr.sc. Murat Hulaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.